



## **KËSHILLA** për të përdorur telefonin celular, kompjuterin dhe internetin

→ **Zgjidhni pajisjet elektrike pas moshës së fëmijëve.**

Në vazhdim disa këshilla që mund t'ju ndihmojnë: mos bleni telefon celular para se fëmija është 9 vjeç, smartphone dhe kompjuter para se fëmija është 12 vjeç.

→ **Shoqërim sidomos në fillim.**

Edhe përdorimi i kompjuterave dhe përdorimi i internetit duhet të mësohet:

Ku mund të gjej diçka, çfarë jom duke kërkuar? Në të cilët faqe mund të kem besim?

Në të cilët faqe duhet të kemi kujdes?

Ndihmoheni fëmijun tuaj që të mësohet të përdor mediat. Për fëmijët e vegjël ju ndihmon një program në kompjuter që fëmijët mund ta përdorin në siguri.

→ **Mbrojtja e të dhënave është shumë e rëndësishme.**

Tregoni fëmijëve tuaj, që të kujdesen në dhënien e gjërave personale, mos të publikojn foto intime dhe mos të publikojn foto të tjerëve pa i pyetur.

→ **Cilësime të sigurt në telefon celular.**

Nuk është e mundur që të bllokoni dis numra të ndryshëm që paguhen me para.

Kontrolloni rregullisht fakturat e telefonit për të pasur siguri.

→ **Rregullat për trajtim.**


Si në internet po ashtu edhe në komunikacion përmes telefonit celular duhet të përdoret me respekt, mos të lëndosh dikë, të shpifësh dikë apo të ofendosh dikë.

→ **A interesoheni për gjërat që i bën fëmiju në internet?**

Le t'ju tregon fëmiju çfarë i pëlqen në internet. Ju duhet të kuptoni, cilat gjëra i pëlqejn fëmijut. Mos i zhvleftësoni interesat e fëmijut tuaj. Vazhdoni të flisni.

→ **Lojëra të përshtatshme kompjuterike.**

Provoni lojërat kompjuterike, pastaj mund ti vlerësoni lojërat e përshtatshme për fëmijun tuaj.



→ **Ndihmë me përvojat negative.**

Kur fëmijët përballen me disa imazhe shqetësuese (foto pornografike, dhunë), ju duhet një person që është prezent dhe që kërkon ndihmë për ata.

→ **Koha për media.**

Është e dobishme që të rregulloni orar të caktuar. Për fëmijë të vegjël mund të përdorni një orë me zile. Kjo është një ide e shkëlqyer. Me fëmijë më të mëdha mund të caktoni një orar për të gjithë javën. Ashtu mund të ndajnë fëmijët kohën për të luajtur.

→ **Koha pa telefon celular.**

Për shembull gjatë kohës së ngrënies, gjatë detyrave të shtëpisë dhe në kohën e gjumit është mirë që mos të përdorni telefon celular. Kjo është mirë për klimën familjare, për relaksim dhe për koncentrim.